

*Këshillë*

*Gruas*

*Muslimane*

nga Shejkh Salih el-Feuzan



## Hyrije:

Gjithë lavdia i takon Allahut, Zotit të gjithëçkaje që ekziston, paqja dhe bekimi qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamed, si dhe mbi Familjen dhe Shokët e tij.

E më pas:

Vëllezerit që kanë marrë përsipër dauetin këtu menduan se kjo ligjëratë duhet të jetë me temë “**Këshillë gruas muslimane**”. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se i gjithë mësimi do të kufizohet vetëm tek gratë. Më saktë, ai është i përgjithshëm por duke u vënë theksin pak më shumë mbi çështje të veçanta për gratë. Gjithashtu, nuk ka dyshim se burri është përgjegjës për gruan e tij ngase Allahu e ka bekuar atë me bashkëshorte që i ka krijuar prej tij, siç Ai thotë:

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ ۚ وَالْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴿١﴾

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikqyres mbi ju.”<sup>1</sup>

<sup>1</sup> En-Nisa, 1

Dhe Ai thotë:

هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَجَعَلَ مِنْهَا زَوْجَهَا لِيَسْكُنَ إِلَيْهَا فَلَمَّا تَغَشَّاهَا  
 حَمَلَتْ حَمْلًا خَفِيًّا فَمَرَّتْ بِهِ فَلَمَّا أَثْقَلتْ دَعَا اللَّهَ رَبَّهُمَا لَئِنْ آتَيْتَنَا صَالِحًا  
 لَنَكُونَنَّ مِنَ الشَّاكِرِينَ ﴿١٨٩﴾

“Është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm (nga Ademi), prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij (Havanë) që ai të gjente prehje tek ajo. Kur njeriu bashkohet me gruan e vet, e ngarkon atë me një barrë të lehtë, që ajo e kalon pa e ndier për ca kohë. Dhe, kur ajo rëndohet, ata të dy i luten Allahut, Zotit të tyre: “Nëse na dhuron pasardhës të shëndoshë, do të të jemi vërtet mirënjohes!”<sup>2</sup>

Urtësia e kësaj është që ai të gjejë prehje tek ajo, të kënaqet nën shoqërinë e saj dhe t’i besojë asaj sekretet dhe çështjet e tij personale që ajo ta ndihmojë në çastet e vështira të jetës dhe që prej tyre të dalin pasardhës të mirë. Allahu thotë:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً  
 وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٢١﴾

“Dhe prej shenjave të Tij është që krijoi për ju bashkëshortet tuaja nga vetet tuaja që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Vërtet, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”<sup>3</sup>

Kjo është një nga shenjat e Allahut, pra është nga argumentet që tregojnë Fuqinë e Mëshirën e Tij dhe të drejtën e Tij për tu adhuruar i vetëm pa i shoqëruar askënd në adhurim, siç Ai thotë:

<sup>2</sup> El-Araf, 189

<sup>3</sup> Er-Rum, 21

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاهُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۗ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ  
عِنْدَ اللَّهِ أَتَقْوَاهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise që të njiheni me njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet dhe i bindet më shumë Atij.”<sup>4</sup>

Kështu, bashkimi i një burri dhe i një gruaje nëpërmjet një lidhjeje të ligjshme është ndër begatitë e Allahut sepse nga kjo lidhje dalin dobi të mëdha, ku më e rëndësishmja është formimi i shoqërisë, krijimi i familjes dhe ndërtimi i shtëpive. Kjo është nga begatitë e Allahut. Dhe për këtë arsye gruas duhet t’i jepet rëndësi e veçantë në aspektin e mësimin dhe udhëzimit të saj, në zgjedhjen e një gruaje besimtare të devotshme, në trajtimin e saj, në mënyrë që burri të mos e shfrytëzojë keq autoritetin e tij ndaj saj duke e shtypur apo keqtrajtuar. Allahu thotë:

وَعَاشِرُوهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ

“Jetoni e silluni mirë me to!”<sup>5</sup>

Dhe Ai thotë:

الطَّلُقُ مَرَّتَانٍ فَإِمْسَاكَ بِمَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحٌ بِإِحْسَانٍ

“Ndarja mund të bëhet dy herë. Më pas, gruaje ose të mbahet me të mirë, ose të lejohet të ikë me të mirë.”<sup>6</sup>

Kështu, lidhja e një burri me një grua është e qëndrueshme dhe e fortë. Kjo lidhje duhet të ndërtohet mbi atë që Allahu e ka bërë të ligjshme për

<sup>4</sup> El-Huxhurat,13

<sup>5</sup> En-Nisa, 19

<sup>6</sup> El-Bekare, 229

bashkëjetesën e ndershme, kujdestarinë fisnike dhe bashkëveprimet e moralshme. Gjithashtu, shijimi dhe kënaqësia e jetës bashkëshortore duhet të jetë në përputhje me atë që ka lejuar Allahu.

Allahu thotë:

نَسَاؤُكُمْ حَرَّتْ لَكُمْ فَاتُوا حَرَّتْكُمْ أَنِّي شِعْتُمْ<sup>ط</sup> وَقَدِّمُوا لِأَنفُسِكُمْ<sup>ج</sup> وَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَعْلَمُوا أَنَّكُمْ

مُلَقَّوهُ<sup>ط</sup> وَدَشِرَ الْمُؤْمِنِينَ

**“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni. Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj (duke përmendur emrin e Allahut para kontaktit). Kijeni frikë Allahun dhe dijeni se do të takoheni me Atë. Dhe përgëzoji besimtarët (se do fitojnë Xhenetin).”<sup>7</sup>**

Pra, duke u bazuar në të gjithë këtë, na bëhet mjaft e qartë rëndësia e gruas në shoqëri. Gruaja është bashkëpunatore dhe bashkëudhëtare e burrit. Qëkur Allahu krijoi njeriun e parë, pra Ademin, Ai gjithashtu krijoi krijoi për të edhe gruan e tij. Ligji i Allahut ne lidhje me këtë do të vazhdojë në po të njëjtën mënyrë deri në Orën e fundit.

سُنَّةَ اللَّهِ فِي الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلُ وَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّةِ اللَّهِ تَبْدِيلًا

**“Kështu ka qenë ligji i Allahut edhe për ata që kanë qenë më parë! Ti kurrsesi nuk do të gjesh ndryshim në ligjet e Allahut.”<sup>8</sup>**

Allahu e ka bërë obligim për burrin që ta adhurojë Allahun e t’i bindet Atij dhe po ashtu e ka urdhëruar gruan që ta adhurojë dhe t’i bindet Allahut pa i shoqëruar akënd në adhurim. Dhe Allahu u ka premtuar vepërmirëve të të dyja gjinive se do t’i shperblejë me një shperblim të pamasë. Po në të njëjtën mënyrë, Allahu i ka paralajmëruar ata që bëjnë vepra të këqija të të dyja gjinive se do t’i mendojë dhe dënojë. Prandaj, përgjithësisht për sa i përkët obligimeve fetare burri dhe gruaja janë të barabartë.

<sup>7</sup> El-Bekare, 223

<sup>8</sup> El-Ahzab, 62



Edhe pse gruaja është veçuar me disa obligime fetare ndryshe nga burri, në përgjithësi, për sa i përket adhurimit të Allahut, bindjes ndaj Tij dhe marrjes së shpërblimit apo dënimit, burri dhe gruaja janë të barabartë. Allahu thotë:

فَأَسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أُضِيعُ عَمَلَ عَمَلٍ مِّنْكُمْ مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْتَىٰ<sup>ط</sup>  
بَعْضُكُمْ مِّنْ بَعْضٍ ۖ فَالَّذِينَ هَاجَرُوا وَأُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ وَأُوذُوا فِي سَبِيلِي  
وَقَتُلُوا وَقُتِلُوا لَأَكْفِرَنَّ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَلَا دُخْلَنَّهُمْ جَنَّتِ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ ثَوَابًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ عِنْدَهُ حُسْنُ الثَّوَابِ ﴿١٦٥﴾

“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: “Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Dhe shpërblimi më i mirë është tek Allahu.”<sup>9</sup>

Nga mesi i burrave ka muslimanë dhe besimtarë, ashtu siç ka nga mesi i grave muslimane dhe besimtare. Po ashtu emigrues (*muhaxhirë*) ka edhe nga burrat edhe nga gratë. Ata janë të gjithë njësoj për sa i përket shpërblimit që do të marrin. Allahu thotë:

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْتَىٰ<sup>ط</sup> وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيٰوةً طَيِّبَةً ۖ وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ  
أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٦٧﴾

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”<sup>10</sup>

<sup>9</sup> Ali-Imran, 195

<sup>10</sup> En-Nahl, 97

Dhe Allahu thotë:

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْقَانِتِينَ وَالْقَانِتَاتِ  
وَالصَّادِقِينَ وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَشِيعِينَ وَالْخَشِيعَاتِ وَالْمُتَصَدِّقِينَ  
وَالْمُتَصَدِّقَاتِ وَالصَّاتِمِينَ وَالصَّاتِمَاتِ وَالْحَافِظِينَ وَالْحَافِظَاتِ فُرُوجَهُمْ وَالْحَافِظَاتِ  
وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا ﴿٣٥﴾

“Me të vërtetë që për muslimanët dhe muslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), durimtarët dhe durimtare, të përlurur dhe të përlurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, ata që e përkujtojnë Allahun vazhdimisht dhe ato që e përkujtojnë Allahun vazhdimisht, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”<sup>11</sup>

Allahu u ka premtuar falje dhe shpërblim të madh të dy palëve, mashkullit dhe femrës, të cilët i zotërojnë këto cilësi të përmendura nga Allahu. Allahu ashtu siç ka urdhëruar burrin, ka urdhëruar dhe gruan. Allahu thotë:

قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَغُضُّوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ وَيَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ ۚ ذَٰلِكَ أَزْكَىٰ لَهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ  
بِمَا يَصْنَعُونَ ﴿٣٥﴾

“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për atë që veprojnë.”<sup>12</sup>

<sup>11</sup> El-Ahzab, 35

<sup>12</sup> En-Nur, 30

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَغْضُضْنَ مِنْ أَبْصَرِهِنَّ وَحَفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ  
 زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ خُمُرَهُنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ  
 إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ أَوْ آبَاءِ بُعُولَتِهِنَّ أَوْ أَبْنَائِهِنَّ أَوْ أَبْنَاؤِ  
 بُعُولَتِهِنَّ أَوْ إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي أَخَوَاتِهِنَّ أَوْ نِسَائِهِنَّ أَوْ مَا  
 مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ أَوِ التَّبِيعِينَ غَيْرِ أُولِي الْأَرْبَةِ مِنَ الرِّجَالِ أَوِ الطِّفْلِ الَّذِينَ  
 لَمْ يَظْهَرُوا عَلَىٰ عَوْرَاتِ النِّسَاءِ وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا تُخْفِينَ مِنْ  
 زِينَتِهِنَّ وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهُ الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٣١﴾

“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t’i hedhin mbulesat e tyre ( të kokës) mbi kraharorët e tyre dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre ose vjehrrëve të tyre ose bijve të tyre ose djemve të bashkëshortëve të tyre ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre ose djemve të motrave a grave të tyre ose atyre që i kanë nën zotërim si (skllavë) ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo femijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!”<sup>13</sup>

Burri është urdhëruar që ta ulë shikimin nga gjëra të cilat Allahu i ka ndaluar, siç janë: shikimi i grave apo gjëra të cilat ngjallin joshje si p.sh pamjet e pamoralshme tek të cilat Allahu na e ka ndaluar të shohim. Këtu hyn gjithashtu edhe shikimi në pjesët e turpshme të njerëzve kur ata janë në shtëpitë e tyre. Kjo është e ndaluar për të dy, edhe për burrin edhe për

<sup>13</sup> En-Nur, 31



gruan sepse ajo të shpie në veprime të turpshme dhe të pamoralshme. Kur Allahu e ndalon diçka, Ai ndalon njëkohësisht edhe mënyrat apo mjetet që të shpien tek ajo. Një shembull konkret i kësaj është shikimi, pasi ai shërben si një mjet. Pejgamberi (*sal-LAll-llahu alejhi ues-selem*) ka thënë: “*Të dy sytë bëjnë zina dhe ajo realizohet me anë të shikimit.*”<sup>14</sup>

Shikimi është shtizë helmuese e shejtanit. Nëse dikush e gjuan, ajo është vërtet një shtizë helmuese e cila e vret atë që e hedh. Pastaj kjo shtizë kthehet tek zemra e atij që sheh.

Shikimi është një shtizë helmuese që i kthehet zemrës së atij që sheh duke e goditur dhe dëmtuar ose duke e vrarë e duke i shkaktuar vdekjen. Krijimi i shikimit është një begati të cilën njerëzit duhet ta shfrytëzojnë vetëm në gjëra që Allahu i ka bërë të lejuara. Njeriu duhet ta shfrytëzojë shikimin vetëm për gjëra që Allahu i ka lejuar dhe duhet t’i shmanget shikimit në gjëra të cilat Allahu i ka ndaluar. Allahu thotë për burrat:

قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَغُضُّوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ

“**Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara).**”<sup>15</sup>

Dhe Ai thotë për gratë:

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَغْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ

“**Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara).**”<sup>16</sup>

Ai thotë për burrat:

وَمَحْفُظُوا فُرُوجَهُمْ

“**...dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)!**”<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Kjo është një pjesë e hadithit të transmetuar nga Imam Ahmedi (2/343) nga Ebu Hurejra (*radij-Allahu ‘anhu*). Hadithi fillon kështu: “*Secili nga bijtë e Ademit ka pjesën e tij në zina: të dy sytë bëjnë zina...*” etj.

<sup>15</sup> En-Nur, 30

<sup>16</sup> En-Nur, 31

Dhe Ai thotë për gratë:

وَنَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ

“...ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme).”<sup>18</sup>

Burri duhet t'i ruajë pjesët e tij të turpshme edhe gruaja po ashtu duhet të ruhet nga ajo që është e ndaluar. Pra, as ai dhe as ajo nuk duhet të bëjnë veprime që i shpiten ata në imoralitet. Kjo arrihet duke u veshur me rroba të cilat i mbulojnë plotësisht pjesët e trupit që nuk lejohet të ekspozohen. Ekspozimi i pjesëve të turpshme është e ndaluar, qoftë për burrat apo gratë sepse kjo gjë ngjall dëshirë dhe epsh e i hap derën së keqes. Kjo është arsyeja përse Allahu e krijoi veshjen për burrin dhe për gruan - si një begati prej Tij:

يَبْنِيْءَ اٰدَمَ قَدْ اَنْزَلْنَا عَلَيْكُمْ لِبَاسًا يُوَارِيْ سَوْءَ تِكُمْ وَرِيْشًا<sup>ط</sup>

“O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim...”<sup>19</sup>

Pra, urtësia e Allahut në krijimin e veshjes qëndron në dy aspekte të rëndësishme. E para është: Mbulimi i pjesëve të turpshme. Dhe e dyta: Zbukurimi dhe stolisja. E më pas, Ai na tregon dhe na vë në dijeni për një veshje që është më e mirë sesa ajo që vishet në trup; dhe ajo është veshja e *Tekuasë* (Devotshmërisë).

وَلِبَاسُ التَّقْوَىٰ ذَٰلِكَ خَيْرٌ

“...por, petku i devotshmërisë është më i miri.”<sup>20</sup>

<sup>17</sup> En-Nur, 30

<sup>18</sup> En-Nur, 31

<sup>19</sup> El-Araf, 26

<sup>20</sup> El-Araf, 26

Të dy, si burri edhe gruaja duhet t'i mbulojnë pjesët e turpshme me një veshje të mjaftueshme sepse kjo e ruan moralin. Kurse sa i përket lakuriqësisë dhe paturpësisë, këto të çojnë në prishjen e moralit, humbjen e nderit dhe përhapjen e imoralitetit. Ndërsa kur pjesët e turpshme mbulohen me veshjen që Allahu mësoi burrin dhe gruan që t'i përmbahen, atëherë kjo i mbron pjesët e turpshme prej zinasë, homoseksualitetit dhe i ruan nga gjërat që Allahu i ka ndaluar.

Më pas, Allahu e veçon gruan me një urdhër ndryshe nga burri, ku Ai thotë:

وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ خُمُرَهُنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ<sup>ط</sup>

“...dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i hedhin mbulesat e tyre të kokës (khumur) mbi kraharorët e tyre...”<sup>21</sup>

Këtu, Allahu i urdhëron gratë të veshin Hixhabin, e cila është një mbulesë gjithëpërfshirëse që mbulon trupin e gruas duke përfshirë fytyrën, duart, këmbët dhe tërë trupin. Këtu përfshihen poashtu edhe flokët, të cilat gruaja duhet t'i mbulojë përpara burrit që nuk është *maharemi* i saj.

“...dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre...” që do të thotë të mos e ekspozojnë bukurinë e tyre, qoftë ajo bukuri trupore dhe këtu përfshihen: trupi, fytyra, duart e të tjera si këto, apo qoftë ajo bukuri artificiale siç janë: stolitë, bojrat e flokëve, *kuhli* (me të cilin lyhen sytë) e kështu me rradhë. Gruaja është urdhëruar që ta mbulojë si bukurinë trupore ashtu edhe atë artificiale, siç janë bojrat e flokëve, stolitë, *kuhli* e të tjera si këto.

“...përveç atyre që janë të dukshme.” Sipas mendimit më të saktë këtu kihet për qëllim veshja e jashtme pra, ka kuptimin: Ajo që është e dukshme, pa e ekspozuar vetë gruaja dhe kjo është veshja e jashtme, e cila nuk ngjall dëshirë apo epush. Më pas, Allahu thotë: “**Le t'i hedhin mbulesat e tyre të kokës (khumur)...**”. *Khumur* është shumësi i fjalës *khimar* që do të thotë të mbulosh ose të bllokosh diçka. Kjo është arsyeja pse *khams* (alkooli) është quajtur me këtë emër sepse ai mbulon dhe bllokon mendjen (pra, të deh).

<sup>21</sup> En-Nur, 31

وَلْيَضْرِبْنَ خُمُرَهُنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ

“Le t’i hedhin mbulesat e tyre të kokës (khumur) mbi kraharoret e tyre...”

Allahu i urdhëron gratë ta lëshojnë poshtë *kbumurin* (mbulesën e kokës). Pra, *kbumuri* është mbulesa që vihet në kokë. Allahu e urdhëron atë që ta lëshojë *kbumurin* (mbulesën e kokës) deri në kraharor: “**Le t’i hedhin mbulesat e tyre të kokës (khumur) mbi kraharorët tyre...**” Këtu kihet për qëllim mbulesa e cila në pjesën e lartme nuk është e mbyllur, por është e hapur në pjesën e gushës dhe qafës dhe bën që këto të fundit të ekspozohen. Gruaja nuk duhet t’i ekspozojë këto pjesë të trupit dhe meshkujt t’i shohin ato por, duhet ta lëshojë poshtë *kbimarin* (mbulesën e kokës) në mënyrë që këto pjesë të mbuloen. Përderisa gruaja është urdhëruar ta mbulojë gushën, në mënyrë të patjetërsueshme mbulohet edhe fytyra. Në fakt, nga lëshimi i *kbimarit* (mbulesa e kokës) mbi kraharor duke mbuluar qafën dhe gushën, patjetër që do mbulohet edhe fytyra. Arsyeja pse kjo ndodh është sepse *kbimari* (mbulesa e kokës) vendoset në kokë. Kështu, përderisa ajo vendoset në kokë dhe zbret poshtë deri në kraharor, edhe fytyra mbulohet njëkohësisht.

Kjo gjë qartësohet më tej nga Aisha (*radij-Allahu ‘anha*): “Kur ishim në *ibram me të Dërguarin e Allahut, ndodhte që aty kalonin burra. Kur ata afroreshin ne e lëshonim pjesën e sipërme të xhilibabit mbi fytyrë. Dhe kur ata largoheshin ne i zbulonim fytyrat.”<sup>22</sup>*

Dhe është gjithashtu thënia e Allahut:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِأَزْوَاجِكَ وَبَنَاتِكَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلِيبِهِنَّ

“O Pejgamber, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të mbështjellin mbulesën e tyre (xhilibabin) përreth trupit.”<sup>23</sup>

<sup>22</sup> Transmetuar nga Imam Ahmedi (6/30), Ebu Davudi (n. 1833) - dhe teksti i mësipërm është nga ai - dhe Ibn Maxheh (n. 2935) nga A’ishah (*radij-Allahu ‘anha*).

<sup>23</sup> El-Ahzab, 59

*Xhibbabi* është një mbulësë shume madhe me të cilën gruaja mbështjell trupin e saj dhe është pikërisht ajo mbulesa që vishet mbi rrobat e tjera që gruaja ka nën të. Allahu i ka urdhëruar gratë që ta hedhin atë mbi fytyrë aq sa të mos duket asgjë prej trupit të saj që nxit epshin e njerëzve.

ذَلِكَ أَدْنَىٰ أَنْ يُعْرَفْنَ فَلَا يُؤْذَيْنَ

“Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët.”<sup>24</sup>

Ky është urdhër për gruan që ajo të veshë *Hixhabin* në trupin e saj dhe në çdo pjesë tjetër provokuese që ngjall epsh. Allahu thotë:

وَإِذَا سَأَلْتُمُوهُنَّ مَتَاعًا فَسَأَلُوهُنَّ مِن وَرَاءِ حِجَابٍ

“Kur të kërkoni prej grave të Pejgamberit diçka, kërkoheni prapa perdes!”<sup>25</sup>

Edhe pse ky ajet i drejtohet grave të Pejgamberit, gjithsesi ai është i përgjithshëm. Pra, marrë fjalë për fjalë ky ajet i drejtohet grave të Pejgamberit por, nga ana kuptimore ai është i përgjithshëm për të gjitha gratë, meqë gratë e Pejgamberit shërbejnë si model për të gjitha gratë muslimane. Allahu e shpjegon këtë plotësisht në vargun pasardhës, ku Ai thotë:

ذَلِكَمَّ أَطْهَرُ لِقُلُوبِكُمْ وَقُلُوبِهِنَّ

“Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të atyre.”<sup>26</sup>

Allahu urdhëroi që grave kur t’u kërkohet diçka, t’u kërkohet pas *Hixhabit*. Fjala *Hixhab* do të thotë: Gjithçka që e mbulon gruan, qoftë ajo rrobë,

<sup>24</sup> El-Ahzab, 59

<sup>25</sup> El-Ahzab, 53

<sup>26</sup> El-Ahzab, 53

mur, derë apo çdo gjë tjetër tjetër që shërben si pengesë midis një gruaje dhe një burri kur ai flet me të, i kërkon diçka apo i jep diçka. Gjithçka duhet të bëhet pas *Hixhabit*, pra pas një pengese apo mbulese. Pra, burri nuk duhet të kontaktojë me një grua pa patur pengesë, mbulesë apo duke qënë e ekspozuar. Por, ajo duhet të qëndrojë pas një pengese që të shërbejë si mbrojtje për të, pavarësisht a është kjo rrobë, mur, derë apo të tilla si këto, për shkak se kjo është **“më e pastër për zemrat tuaja dhe të atyre”** nga ngjallja e epshit. Nëse gratë e mbrojnë veten me anë të *Hixhabit* dhe nuk shihen nga burrat, atëherë zemrat e të dy palëve do të jenë të mbrojtura prej dëshirës dhe epshit. Kjo shihet mjaft qartë në shoqëritë muslimane, të cilat janë të kapura rreptësisht pas *Hixhabit*.

Një shoqëri e cila është e kapur fort pas *Hixhabit* është e ruajtur prej prishjes së moralit. Në fakt, është pikërisht mungesa e *Hixhabit* që shkakton imoralitet dhe ndezjen e dëshirave tek meshkujt. Prandaj thënia e Allahut: **“Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të atyre”** përmban një domethënie që është e përgjithshme për të gjithë Umetin për shkak se *Hixhabi* ka për qëllim pastrimin e zemrave të të dy palëve, edhe meshkujve edhe femrave në mënyrë të barabartë. Ajo mbyll çdo shteg që të shpie në prishjen e moralit.

Që të ruhet nderi i burrit dhe i gruas, që të ruhen zemrat nga tundimi dhe si një mënyrë për mbylljen e çdo shtegu që çon në prishje, gruaje është e kufizuar nga të udhëtuarit vetëm, pa *mahrem*. Kjo për shkak se nëse një grua shoqërohet nga *mahremi*, ai do ta mbrojë, do ta ruajë dhe do të kujdeset për nevojat e saj. Pejgamberi (*sal-LAllahu alejbi ues-selem*) ka thënë: *“Nuk i lejohet gruas që beson Allahun dhe Ditën e Fundit, që të udhëtojë dy ditë pa mahrem.”*<sup>27</sup>

Në një transmetim tjetër thuhet *“një ditë dhe një natë”*,<sup>28</sup> ndërsa në një tjetër thuhet: *“të udhëtojë”*,<sup>29</sup> pa përcaktuar afat kohor.

Por ajo që kihet për qëllim është se gruaje nuk duhet të udhëtojë vetëm, pa *mahrem*. Dhe nëse ajo e bën këtë, pra të udhëtojë pa *mahrem*, ajo nuk i është bindur Allahut dhe të Dërguarit të Tij, duke vepruar kështu diçka që

<sup>27</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (2/219-220) nga Ebu Se'id el-Khudrij (*radij-Allahu 'anhu*).

<sup>28</sup> Transmetuar nga Imam Muslimi (n. 1339) nga Ebu Hurejrah (*radij-Allahu 'anhu*).

<sup>29</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (4/18) dhe Imam Muslimi (n. 1341).



Allahu e ka ndaluar dhe duke bërë *fitne*. Kjo zbatohet përgjithësisht për çdo situatë dhe periudhë kohore.

Ndërsa, sa i përket disa njerëzve që thonë se: nëse gruaja udhëton e shoqëruar nga një grup tjetër grash, këto zvendësojnë *mahrem*, atëherë kjo bie në kundërshtim me thënien e Pejgamberit (*sal-LAllahu alejhi ues-selem*): “Nuk i lejohet gruas që beson Allahun dhe Ditën e Fundit, që të udhëtojë për dy ditë pa mahrem.”<sup>30</sup>

Një grup grashë nuk mund të jenë *mahrem* për një grua. Mahremi i gruas është i njohur: ai është një mashkull me të cilin ajo e ka të ndaluar martesën, për shkak të lidhjeve familjare, si p.sh: babai, djali, xhaxhai, daja ose edhe nga lidhjet martesore siç janë: babai i burrit, djali i burrit apo edhe nga lidhjet për gjiri, bazuar në thënien e Pejgamberit (*sal-LAllahu alejhi ues-selem*): “Lidhjet prej gjiri e bëjnë të ndaluar atë që është e ndaluar nga lidhjet familjare.”<sup>31</sup>

Për këtë arsye *mahremi* i një gruaje është personi më të cilin ajo e ka të ndaluar martesën për shkak të lidhjeve familjare ose diçka të ngjashme. Ky ndalim (i martesës) duhet të jetë i vazhdueshëm, pra i përherëshëm.

Në këtë kategori nuk bën pjesë ndalesa e përkohëshme, siç është motra e gruas, halla apo tezza e gruas. Kjo ndalesë martesë është vetëm për një kohë të caktuar. Kjo është arsyeja pse burri nuk është *mahrem* për motrën e gruas edhe pse atij i ndalohet martesa me të pra, për shkak se ndalimi i martesës me të është i përkohëshëm (jo i përherëshëm). Po ashtu, ai nuk mund të jetë mahrem për hallën dhe tezen e gruas. Pra, përkufizimi i *mahrem* është ky që sapa thamë. Ndërsa sa i përket një grupi grashë, ato nuk janë *mahrem*.

Pejgamberi (*sal-LAllahu alejhi ues-selem*) ka caktuar për gruan *mahrem* që ta shoqërojë atë kur ajo udhëton në cdo lloj rrethane, qoftë kur udhëton në këmbë, me kafshë, me makinë apo me avion. Disa njerëz sot pretendojnë se nuk ka problem nëse gruaja udhëton me avion dhe një nga *mahremët* e saj e përcjell atë në aeroport kur ajo të niset për udhëtim dhe një tjetër

<sup>30</sup> Transmetuar nga Imam Muslimi (n. 1339) nga Ebu Hurejrah (*radij-Allahu ‘anhu*).

<sup>31</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (3/149) nga Ibn ‘Abbasi (*radij-Allahu ‘anhumā*).

*mahrem* ta presë në aeroport kur ajo të mbërrijë. Ne themi: Jo, kjo nuk lejohet sepse ajo ka udhëtuar pa *mahrem*. Dhe Pejgamberi (*sal-LAllahu alejhi ues-selem*) ka thënë: “Nuk i lejohet gruas që beson Allahun dhe Ditën e Fundit, që të udhëtojë për dy ditë pa *mahrem*.” Pra, kjo vlen si për udhëtimin në këmbë, me makinë apo me kafshë. Pejgamberi (*sal-LAllahu alejhi ues-selem*) nuk e ka specifikuar. Gjithësesi arsyeja qëndron në faktin se ajo mund të bjerë në fitne edhe nëse udhëton me avion. Pra, ajo nuk është e sigurt prej fitnes edhe nëse ndodhet në bordin e një avioni.

Ose le të supozojmë për shembull se avioni është i detyruar të ndryshojë destinacion dhe ulet në një tjetër shtet, kush do të shkojë ta marrë këtë grua në këtë vend të huaj? Kjo është arsyeja përse duhet të ketë gjithmonë një *mahrem* që ta shoqërojë atë. Njëherë një burrë shkoi tek Pejgamberi, (*sal-LAllahu alejhi ues-selem*) dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, kam shënuar emrin për të marrë pjesë në këtë e në atë betejë, por gruaja ime ka shkuar të bëjë Haxhin.” Pejgamberi (*sal-LAllahu alejhi ues-selem*) i tha: “*Kthehu dhe bëj Haxhin me gruan tënde.*”<sup>32</sup>

Pejgamberi (*sal-LAllahu ‘alejhi ues-selem*) e ktheu mbrapa këtë burrë që të mos shkonte në betejë me qëllim që të shqëronte gruan e tij që do të bënte Haxhin dhe të ishte *mahrem* për të. Ky është argument se pasja e një *mahremi* është kusht për gruan që shkon për Haxh apo kudoqoftë tjetër, pavarësisht a është me një grup njërëzish apo jo. Kjo për arsye se dijetarët e *Fik’hut* - Allahu i mëshiroftë të gjithë ata - kanë përmendur se një nga kushtet në të cilat Haxhi bëhet i detyrueshëm për gruan, është kur ajo e ka një *mahrem* që e shoqëron. Në të kundërt, nëse ajo nuk e ka një *mahrem*, Haxhi nuk është i detyrueshëm për të, derisa ajo ta ketë një *mahrem*.

Po ashtu, Islami ndalon që burri të jetë vetëm për vetëm me një grua, pra të jenë vetëm në një vend të izoluar pa praninë e dikujt tjetër sepse kjo shpie në fitne. Pejgamberi (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “*Kujdes se mos hyni tek gratë!*” Shokët e tij e pyetën: “Po *el-hamu* (d.m.th. dikush nga vëllezërit e burrit, nipërit e tij ose kushurinjtë e tij)?” Ai tha: “*Ai është vdekja.*”<sup>33</sup> Kjo ka kuptimin: rreziku i këtyre pjestarëve të familjes së tij është akoma më i madh. Përse kështu? Sepse gruaja është më pak e

<sup>32</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (2/219) nga Ibn ‘Abbasi (*radij-Allahu ‘anbuma*).

<sup>33</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (6/158-159) nga ‘Ukbeh bin ‘Amir (*radij-Allahu ‘anhu*).

kufizuar ndaj vëllezërve apo kushërinjve të burrit sesa ndaj meshkujve të tjerë. Shmangia prej tyre është më e vogël. Por megjithatë, duhet të tregohet kujdes dhe maturi me meshkujt e familjes së burrit.

Ndërsa çfarë dëgjojmë sot nga disa injorantë se gruaja mund të përsëndetet, mund t'i japë dorën apo mund të qëndrojë vetëm për vetëm me vëllain e burrit, xhaxhain e burrit apo të tjerë meshkuj nga fisi i burrit, kjo është diçka e pabazë. Nuk i lejohet dikujt që nuk është *mabremi* i një gruaje që të qëndrojë vetëm me të (kur ajo është e pambuluar), as t'i japë dorën dhe as të qëndrojë vetëm për vetëm me të, por vetëm në rast se aty ndodhet dikush tjetër, në mënyrë që mes të dyve të mos ketë intimitet. Ndërsa ai që hyn në shtëpi dhe nuk ka njeri tjetër përveç saj dhe ai nuk është *mabrem* për të, atëherë ky është intimitet i ndaluar dhe është i rrezikshëm.

Një tjetër shembull i kësaj është edhe nëse një burrë hyn në një dhomë bosh dhe në shtëpi ndodhet vetëm gruaja. Kjo nuk lejohet sepse është rrugë që të shpie në fitne. Po ashtu, i njëjti rast edhe sikur burri që ndodhet vetëm me një grua të jetë doktor. Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “*Nuk ka burrë që ndodhet vetëm me një grua, veçse shejtani është i treti mes tyre.*”<sup>34</sup> Kjo do të thotë se shejtani është i pranishëm mes tyre dhe ua zbukuron imoralitetin. Kjo për shkak se ai gjithmonë fton në fitne dhe e shfrytëzon këtë rast që të përhapë imoralitetin mes tyre. Dhe që t'i mbyllet çdo shteg shejtanit, gjërave që të çojnë tek ajo si dhe çdo rrugë që të çon në prishje, Sheriati e ka ndaluar burrin dhe gruan të rrijnë vetëm për vetëm.

Një nga format e reja të kësaj ndalese që po ndodh ditët e sotme, është kur një grua udhëton vetëm me taksistin i cili nuk është *mabremi* i saj. Ai e çon atë në shkollë, në dyqan apo në xhami! Kjo nuk lejohet. Nuk i lejohet një gruaje të udhëtojë e vetme me taksistin në makinë, i cili nuk është *mabrem* për të sepse kjo është nga format e ndaluara të intimitetit.

Gruaja muslimane, sidomos në ditët e sotme kur gratë kanë filluar të shkojnë në punë, nëpër pazare, nëpër të afërmit e tyre e kështu me rradhë,

<sup>34</sup> Transmetuar nga Tirmidhiu (n. 1171) dhe një transmetim të ngjashëm ka edhe Imam Ahmedî në *Musnedin* e tij (1/18), të dy kanë transmetuar nga ‘Umer bin el-Khattab (*radij-Allahu ‘anhû*).

duhet ta dijë se ky lloj intimiteti është i ndaluar, qoftë në shtëpi, në makinë apo kudoqoftë tjetër.

Gruaja muslimane nuk duhet ta teprojë me daljet jashtë shtëpisë, vetëm nëse është vërtet e nevojshme për të dalë. Dhe nëse i duhet patjetër të dalë, ajo duhet të mbulohet në mënyrën e duhur dhe të mos hedhë parfum. Për arsye se nëse ajo del jashtë e parfumosur, kjo i hap derën të keqes, tërheq shikimet e njerëzve, meshkujt ngulin sytë tek ajo dhe i shkojnë nga pas.

Kështu, sa më shumë të rrijë gruaja në shtëpi, aq më e mbrojtur është. Allahu u drejtohet grave të Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) të cilat janë shembull për të gjitha muslimane, duke u thënë:

وَقَرْنَ فِي بُيُوتِكُنَّ

“Qëndroni në shtëpitë tuaja.”<sup>35</sup>

Këtu është fjala *karar*, që do të thotë të qëndrosh ose të mbetesh dhe mos të mos dalësh jashtë sepse kjo është më e mira për mbrojtjen e gruas. Kështu që, sa më shumë të qëndrojnë në shtëpi, aq më mirë është për të. Dhë në rastin kur e ka të nevojshme të dalë, ajo mund ta bëjë vetëm pasi të mbulohet.

Allahu kënaqet shumë kur gruaja falet në shtëpinë e saj dhe nuk del për tu falur në xhami, edhe pse xhamia është vendi i adhurimit dhe pastërtisë. Por dalja e saj sjell shumë të këqija, prandaj falja e namazit në shtëpi është më e mirë për të sesa falja në xhami. Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “Mos i ndaloni robëreshat e Allahut të shkojnë në xhamitë e Allahut. Mirëpo, shtëpitë e tyre janë më të mira për to.”<sup>36</sup>

Kuptimi: Falja e namazit në shtëpi është më e mirë për to sesa falja në xhami.

<sup>35</sup> El-Ahzab, 33

<sup>36</sup> Transmetuar nga Imam Ahmedi (2/16 dhe 76), Imam Bukhari (1/216), Imam Muslimi (n. 442), Ebu Davudi (n. 879) dhe Maliku në *el-Muwetta* (n. 465) nga Ibn 'Umeri (*radij-Allahu 'anhuma*). Është transmetuar gjithashtu nga Imam Ahmedi (2/475), Ebu Davudi (n. 566), ed-Darimi (n. 1282) nga Ebu Hurejrah (*radij-Allahu 'anh*).

Ai (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë gjithashtu: “Le të dalin gratë pa aromë.”<sup>37</sup> Që do të thotë: të pazbukuruara dhe të paparfumosura.

Shumë gra sot kanë rënë në sprovën e të dalurit nga shtëpitë e tyre për gjëra të parëndësishme, madje sillen kot vërdallë nëpër pazare, të zbukuruara, të parfumosura dhe me fytyrën jashtë. Kur futen nëpër dyqane dhe shkojnë aty ku ndodhen veshjet e zbulojnë fytyrën përpara shitësave apo puntorëve sikur ata të ishin *mahremët* e tyre! Bëjnë muhabetë, qeshin dhe bëjnë shaka mes veti. Ku është modestia, o gra muslimane?! A nuk e keni frikë Allahun?!

Gjithashtu, kërkohet prej gruas që kur të dalë nga shtëpia e saj, të veshë mbulesë të gjerë, të bollshme, që e fsheh trupin e saj dhe është pa zbukurime. Duhet të jetë mbulesë tepër e madhe dhe e lirëshme që lëshohet në të gjithë trupin dhe të mos ngjitet pas trupit e të nxjerrë format e tij.

Prandaj mbulesa e gruas duhet të ketë disa veçori:

E para: Të jetë e bollshme dhe jo e ngushtë.

E dyta: Të jetë gjithëpërfshirëse, ta mbulojë të gjithë trupin dhe të mos duket asnjë pjesë e tij, as duart, as këmbët e as fytyra. Pra, duhet ta mbulojë të gjithë trupin.

E treta: Nuk duhet të ketë zbukurime apo qëndisje. Ajo duhet të jetë veshje e zakonshme, të mos ketë zbukurime që tërheqin vëmendjen. Gruaja muslimane duhet ta dijë se për çfarë na ka njoftuar Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) kur ka thënë: “Dy grupe njerëzish prej banorve të zjarrit nuk i kam parë akoma: gra që janë të veshura, por të zhveshura, përdridhen dhe bëjnë njerëzit të dridhen, kokat e tyre janë si gungat e deveve; ato nuk kanë për të hyrë në Xhenet dhe nuk do ta ndjejnë aromën e tij dhe pse ajo ndjehet nga një largësi e madhe.”<sup>38</sup>

<sup>37</sup> Transmetuar nga Imam Ahmedî (2/438), Ebu Davudi (n. 565), ed-Darimi (n. 1282) nga Ebu Hurejrah (*radij-Allahu 'anhu*); Imam Ahmedî (5/192 dhe 193) nga Zejd bin Khalid el-Xhuhejni (*radij-Allahu 'anhu*); dhe Imam Ahmedî (6/69-70) nga A'ishah (*radij-Allahu 'anhu*).

<sup>38</sup> Transmetuar nga Imam Ahmedî (2/356) dhe Imam Muslimi (n. 2128) nga Ebu Hurejrah (*radij-Allahu 'anhu*).

Thënia e Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*): “Gra të veshura, por të *zhevshura*” do të thotë se ato janë të veshura. Por, këto veshje nuk i mbulojnë ato ose për arsye se janë të shkurtra dhe nuk përfshijnë gjithë trupin dhe për rrjedhojë, dalin duart, parakrahet, këmbët dhe kërciri, ose për shkak se e përfshijnë gjithë trupin, por janë të tejdukshme dhe për rrjedhojë duket çfarë ka nën të. Kështu ka ndodhur në ato vende që nuk pajtohen me etikën islame. Dhe kjo sjellje po pasohet nga gratë e këtij vendi, përveç atyre që Allahu i ka përfshirë në Mëshirën e Tij. Këto janë prej zakoneve të injorancës. Allahu thotë:

وَقَرْنَ فِي بُيُوتِكُنَّ وَلَا تَبَرَّجْنَ تَبَرُّجَ الْجَاهِلِيَّةِ الْأُولَىٰ<sup>ط</sup>

**“Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja (teberruxh), ashtu siç zbuloheshit në kohën e injorancës!”<sup>39</sup>**

Këtu, fjala *teberruxh* ka kuptimin ta tregosh dhe ta shfaqësh veten haptazi, pra shfaqja hapur e zbukurimeve të gruas përpara një burri. Ky është *teberruxhi*.

Prandaj, ajo çfarë kërkohet nga gruaja kur ajo del nga shtëpia, është që të dalë pa *teberruxh*, pra pa e shfaqur zbukurimin e saj. Madje, Allahu i ka ndaluar edhe gratë e moshuara që ta shfaqin dhe tregojnë zbukurimin e tyre, ku Ai thotë:

وَالْقَوَاعِدُ مِنَ النِّسَاءِ الَّتِي لَا يَرَجُونَ نِكَاحًا فَلَيْسَ عَلَيْهِنَّ جُنَاحٌ أَنْ يَضَعْنَ  
ثِيَابَهُنَّ غَيْرَ مُتَبَرِّجَاتٍ بِزِينَةٍ<sup>ط</sup>

**“Gratë e moshuara, që nuk shpresojnë më të martohen, nuk është gjynah ta heqin mbulesën e jashtme, por jo duke i treguar stolitë e tyre.”<sup>40</sup>**

Kështu, përderisa është e ndaluar ekspozimi i zbukurimeve nga gruaja e moshuar që nuk shpreson të martohet, çfarë mund të themi pastaj për një grua të re, po për një grua të bukur, po për një grua që dëshirohet për

<sup>39</sup> El-Ahzab, 33

<sup>40</sup> En-Nur, 60



martesë, si mund të dalë jashtë shtëpisë duke e shfaqur veten në mënyrë kaq të paturpshme dhe duke treguar zbulimet e saj. Kjo është një nga karakteristikat e Ditëve të Injorancës.

Gruaja e cila i frikësohet Allahut dhe Botës tjetër duhet të qëndrojë larg shumë gjërave që po bëjnë gratë e sotme, si për shembull, ato bëjnë lëshime në veshje (*hixhab*), janë të pakujdesshme me rrobat që kanë zbulime, në parfumosje kur dalin jashtë, përzihen me meshkujt dhe bejnë shaka me ta. Allahu, më i Larti, u thotë grave të Pejgamberit (*salallahu 'alejhi ue sel-lem*):

يٰۤاَيُّهَا النِّسَاءُ لَسْتُنَّ كَأَحَدٍ مِّنَ النِّسَاءِ ۚ إِنِ اتَّقَيْتُنَّ فَلَا تَخْضَعْنَ بِالْقَوْلِ فَيَطْمَعَ الَّذِي فِي قَلْبِهِ مَرَضٌ وَقُلْنَ قَوْلًا مَّعْرُوفًا ﴿٣٢﴾

**“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër ephore, por flisni drejtë dhe në mënyrë të ndershme!”<sup>41</sup>**

Nëse gruas i duhet patjetër që të flasë me një burrë që nuk është prej *mahremëve* të saj, ajo mund ta bëjë këtë por, me një zë të zakonshëm, të mos jetë i ëmbël apo i butë, jo duke qeshur e bërë shaka. Por, me një zë të thjeshtë, sipas nevojës që ka, pra pyetje-përgjigje, për aq sa i nevojitet. Nuk duhet të flasë në mënyrë miqësore, provokuese, duke qeshur apo me zë të shtirur apo të zbuluar, e si rrjedhojë të nxisë dëshirën e atij që ka sëmundje në zemër. Nisur nga thënia e Allahut:

وَقُلْنَ قَوْلًا مَّعْرُوفًا

**“...por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!”<sup>42</sup>**

Gratë e sotme Muslimane duhet t'i frikësohen Allahut në lidhje me vetet e tyre dhe shoqërinë. Gjithashtu, gratë e ditëve të sotme, aq më tepër gratë muslimane, duhet të përqëndrohen në rritjen e djemve dhe vajzave të tyre në shtëpi, për shkak se ato do të pyeten për fëmijët e tyre që i kanë nën ruajtje e nën kujdes.

<sup>41</sup> El-Ahzab, 32

<sup>42</sup> El-Ahzab, 32

Ato duhet t'i edukojnë vajzat e tyre me sjellje të hijëshme, me rregull, t'i mësojnë të mbulohen dhe dhe të jenë modeste. Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “Çdo njeri nga ju është bari dhe çdo njeri nga ju është përgjegjës për tufën e tij. Gruaja është baresha e shtëpisë së burrit dhe është përgjegjëse për të.”<sup>43</sup>

Pra, gruaja duhet t'i rrisë fëmijët me sjellje të drejtë, për shkak se të gjithë fëmijët që jetojnë në shtëpi me të janë nën kujdesin e saj dhe ajo është përgjegjëse për ta.

Poashtu, nga gjërat që Allahu i ka bërë të ndaluara për gratë është edhe ndryshimi i krijimit të Tij, gjë për të cilën shejtani është betuar se do ta urdhërojë Birin e Ademit ta bëjë:

وَلَا مَرْنَهُمْ فَلْيَغْيِرَنَّ خَلْقَ اللَّهِ

“...do t'i urdhëroj që të ndryshojnë krijimin e Allahut.”<sup>44</sup>

Shpjegimi i këtij ajeti Kur'anor që nënkupton për heqjen e vetullave, tatuazhet, limimin e dhëmbëve, shtimin e flokëve (ekstensionit) na ka ardhur në hadith: “Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) e ka mallkuar gruan që u heq vetullat të tjerëve dhe atë që heq vetullat e saj; gruan që u shton flokët të tjerëve dhe atë që shton flokët e saj; gruan që u bën tatuazh të tjerëve dhe atë që bën tatuazh.”<sup>45</sup>

*Namisëh*, është gruaja që heq qimet e vetullave duke i prerë, duke i rruajtur, duke i shkukur apo me çfarëdolloj mënyre më të cilën mund të hiqen vetullat. Kjo është ajo që njihet me emrin *en-nems* (heqja e vetullave) për të cilën Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) mallkoi çdo grua që e vepron. Ndërsa, *mutenamisëh* është gruaja që u kërkon të tjerëve t'i heqin vetullat. Edhe ajo poashtu, është e mallkuar, bazuar në thënien e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*).

<sup>43</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (8/104) nga Ibn 'Umeri (*radij-Allahu 'anhuma*).

<sup>44</sup> En-nisa, 119

<sup>45</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (71/61-62) nga transmetimi i 'Abdullah bin Mes'ud (*radij-Allahu 'anh*).

Ka gra të cilat janë sprovuar me krimin e heqjes së vetullave ngaqë ndjekin gratë jobesimtare, gratë e përdala dhe injorante që nuk u bën përshtypje mosbindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Pastaj, pasi i heqin vetullat i vizatojnë me bojë ato. Ah, sa i pastër është Allahu nga çdo mangësi! A janë bojrat më të mira se vetullat? A janë më të mira se ajo që ka krijuar Allahu? Ky është ndryshim i krijimit të Allahut. Pra, nuk i lejohet gruas Muslimane të ndjekë këto veprime të poshtra, zakone të pamoralshme dhe ndryshimin e krijimit të Allahut.

*Uashimeh* është gruaja që bën tatuazhe duke ngulur gjilpëra në lëkurë ose duke e prerë lëkurën deri në atë pikë sa të dalë gjak dhe pastaj e ngjyros me bojë, aq shumë lëkurën saqë ngelen vija jeshile në dorë apo edhe në fytyrë. *Uasham* quhet tatuazhi.

*Musteushimeh* është gruaja që kërkon t'i bëhet tatuazh. Kjo është një formë e shndërrimit dhe ndryshimit të krijimit të Allahut. Pasha Allahun, cila nga të dyja është më e mirë, ngjyra natyrale e lëkurës, të cilën e ka krijuar Allahu apo kjo ngjyrë e shëmtuar? Ky është pasim i verbër dhe bindje ndaj shejtanit në atë që ai ka urdhëruar:

وَلَا تُرِيدُوا مَرْئِيَهُمْ فَلْيَغَيِّرُوا خَلْقَ اللَّهِ

“...do t’i urdhëroj që të ndryshojnë krijimin e Allahut.”<sup>46</sup>

*Uasileh* është gruaja e cila flokëve të saj natyral i shton flokë të tjerë jonatyral. Ky është mashtrim dhe largim prej rrugës së drejtë. Një shembull i kësaj është kur gruaja vë paruke ose kur mbi flokët natyral vë flokë shtesë saqë duken sikur janë flokët e saj natyral, por në fakt ato nuk janë flokët e saj ose mund të jenë të dikujt tjetër. Kjo grua është *uasileh* dhe kjo është njësoj e mallkuar sikurse ajo që u kërkon të tjerëve ta bëjnë këtë.

Gjithashtu, *el-uesher* do të thotë: të limosh apo të ndash dhëmbët. “Pejgamberi (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) i ka mallkuar gratë që i ndajnë dhëmbët për bukuri.”<sup>47</sup> Këtu kihet për qëllim gruaja e cila i limon dhe i

<sup>46</sup> En-Nisa, 119

<sup>47</sup> Shiko Sahihun e Bukharit (7/61-62) nga ‘Abdullah bin Mes’udi (*radij-Allahu ‘anhu*).

ndan dhëmbët duke menduar se kjo është prej bukurisë, kur në fakt ajo është bindje ndaj shejtanit. *Uesher* është i ndaluar. Kurse sa i përket rregullimit të dhëmbëve për shkak të dëmtimit apo prishjes së tyre dhe që kanë nevojë për rregullim, këtu nuk ka gjë të keqe përderisa ka të bëjë me mjekimin apo rregullimin e tyre. Kurse, dhëmbët që nuk kanë probleme ose sëmundje (d.m.th. janë të shëndetshëm), nuk i lejohet gruas që t'i limojë, t'i ndajë apo gjëra të tilla si këto.

Po ashtu, Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) e ka mallkuar gruan që qan me kujë dhe gruan që u kërkon të tjerëve të bëjnë diçka të tillë.<sup>48</sup> *Na'ibeh* është gruaja që klith me zë të lartë në rast fatkeqësie.

Po ashtu, “Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) e ka mallkuar gruan *salikah*, *halikah* dhe *shakah*.”<sup>49</sup>

*Salikah* është gruaja që ulëret me të madhe në rast fatkeqësie. Kjo është një nga mëkatet e mëdha. Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë (kuptimi i hadithit): “Nëse gruaja që vajton me kujë dhe nuk pendohet përpara se të vdesë, Ditën e Gjyqimit do të ringjallet me rroba prej zifti e katrani.”<sup>50</sup>

Në Ditët e Injorancës, njerëzit merrnin gra dhe i paguanin që të qanin me vajtim kur vdiste dikush. Kjo është e ndaluar. Ndërsa, të qash dhe të lotosh pa zë për dikë që ka vdekur, këtu nuk ka gjë të keqe. Njëherë Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) në një rast ka qarë dhe tha: “Kjo është prej mëshirës që Allahu ka vënë në zemrat e robërve.”<sup>51</sup>

Kurse, nervozizmi, pakënaqësitë, dëshpërimi... të shprehura me zë të lartë dhe vajtimi me kujë e dëmtojnë të vdekurin në varr. Ka ardhur në hadith se Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “I vdekuri dënohet në varr për shkak të vajtimin për të.”<sup>52</sup>

<sup>48</sup> Transmetuar nga Imam Ahmedi (3/65) dhe Ebu Davudi (n. 3128), nga Ebu Se'id el-Khudrij (*radij-Allahu 'anhu*)

<sup>49</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (2/83) nga Ebu Musa (*radij-Allahu 'anhu*) me tekstin: “I Dërguari i Allahut (*radij-Allahu 'anhu*) e distancoi veten e tij nga...”

<sup>50</sup> Transmetuar nga Imam Muslimi (n. 934) dhe Ebu Davudi (n. 3128) nga Ebu Se'id el-Khudrij (*radij-Allahu 'anhu*).

<sup>51</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (2/80) dhe Imam Muslimi (n. 923) nga Usameh bin Zejd (*radij-Allahu 'anhu*).

<sup>52</sup> Transmetuar nga Imam Bukhari (2/81-82) nga Mugirah (*radij-Allahu 'anhu*).

*Halikah* është gruaja që qeth flokët në rast fatkeqësie, kurse *shakah* është gruaja që gris rrobat në pjesën e gushës ose gris fustanin kur ndodh ndonjë fatkeqësi. Të gjitha këto janë shfaqje e qartë e nervozizmit dhe pakënaqësisë ndaj Urdhërit dhe Kaderit të Allahut, njëkohësisht edhe mungesë durimi.

Ajo çfarë kërkohet në rast fatkeqësie është durim dhe vetëpëmbajtje.

Allahu thotë:

وَدَشِّرِ الصَّابِرِينَ ﴿١٥٥﴾ الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُمُ مُصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ ﴿١٥٦﴾  
 وَأُولَئِكَ عَلَيْهِمْ صَلَوَاتٌ مِّن رَّبِّهِمْ وَرَحْمَةٌ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُهْتَدُونَ ﴿١٥٧﴾

“Prandaj, përgëzoji të duruarit, ata të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!” Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; dhe pikërisht ata janë të udhëzuarit!”<sup>53</sup>

**Si përfundim:** Gruaja ka përgjegjësi dhe detyra në këtë jetë. Ajo është përgjegjëse për veprimet e saj. Ajo është urdhëruar të veprojë mirë dhe është ndaluar nga veprimi i të keqes. Ajo do të shpërblehet dhe do të dënohet, po ashtu. Ajo mban një përgjegjësi të jashtëzakonshme. Shoqëritë e kaluara dhe ato të sotmet shumicën e rasteve janë shkatërruar veçse për shkak të grave. Kështu që, gruaja është mjet që të çon në rrezik nëqoftëse ajo nuk kujdeset për veten dhe nëqoftëse shoqëria nuk e mbron atë.

Ligjëratat rreth grave mund të vazhdojnë pambarim. Por kjo është e mjaftueshme. Lavdërimi dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë Muhamed, si dhe mbi Familjen dhe Shokët e tij.

FUND,  
 BURIMI: [AL-IBAANAH.COM](http://AL-IBAANAH.COM)  
 PËRKTHEU: UMM 'AKIL  
 'AUALI, MEKKEH

<sup>53</sup> El-Bekare, 155-157